



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Rruga Naim Frashëri Nr 37, Tiranë , ALBANIA

## **PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS BIOLOGJI**

### **1) HYRJE**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të biologjisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA, për t’u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së biologjisë për t’u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MASH-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve,
- programet përkatëse lëndore,
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi si dhe të lëndës së biologjisë në veçanti,
- përmbajtjen shkencore të lëndës së biologjisë sipas programeve lëndore përkatëse.

### **2) QËLLIMI I PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të biologjisë është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore.

<sup>1</sup> Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASH që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t'u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së biologjisë të arsimit parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.
- *Së dyti*, si një program i detyruar, veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

### **3) PËRMBAJTJA E PROGRAMIT**

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të biologjisë është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilën fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së biologjisë që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke patur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit si dhe në standardet e mësuesit të lëndës së biologjisë. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

## PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

### Fusha : Dokumentet zyrtare

#### Rezultati

#### Mësuesi do të jetë i aftë të...

- shpjegojë ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi;
- shpjegojë organizimin dhe funksionimin e strukturave organizative të shkollës;
- zbatojë udhëzimet për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;
- zbatojë udhëzimet për zbatimin e reformës kurrikulare në gjimnaz;
- zbatojë udhëzimet për personelin e shkollës;
- respektojë të drejtat dhe liritë e nxënësit;
- respektojë detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit.

#### Literatura

- Dispozitat Normative për arsimin parauniversitar (DN).
- Të drejtat e nxënësve (Neni 21).
- Qeveria e nxënësve (Neni 37).
- Mësuesi, të drejtat e detyrat (Nenet 43, 44, 45).
- Organet kolegjiale në shkollë (Nenet 51, 53, 54).
- Udhëzimi Nr. 49, dt. 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve".
- Udhëzimi Nr.38, dt. 09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë".
- Udhëzimi Nr. 35, dt. 09.10.2007 i MASH "Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor".
- Udhëzimi Nr. 37, dt. 09.10.2007 i MASH "Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore".
- Punimi i Udhëzimit të MASH Nr. 17, datë 29.06.2010 "Për strukturën dhe planet mësimore në Arsimin Parauniversitar për vitin shkollor 2010-2011".
- Punimi i Udhëzimit Nr. 21, datë 23.07.2010 "Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar".
- Punimi i Udhëzimit të MASH, Nr. 26 datë 10.08.2010 "Për mbarëvajtjen e punës mësimore edukative në sistemin e Arsimit Parauniversitar në vitin shkollor 2010-1011.
- Udhëzimi i Alterteksit 2010-2011
- Rregulloren Nr 4998, datë 27.07.2010 për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz
- Udhëzuesi kurrikular i gjimnazit, IZHA, 2010.

## Fusha : Programet lëndore

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë të...	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> <li>tregojë parimet mbi të cilat ndërtohen programet e biologjisë;</li> <li>përcaktojë dhe të vlerësojë ndryshimet në programet e reja të biologjisë;</li> <li>shpjegojë strukturën e programeve të biologjisë (formatin, rubrikat e tij, parimet dhe kriteret, linjat, nënlinjat);</li> <li>përshkruajë hapat që ndiqen për hartimin e planit vjetor, bazuar në programin lëndor;</li> <li>tregojë koherencën vertikale të kurrikulës së biologjisë (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të biologjisë nga njëri vit në tjetrin.)</li> <li>demonstrojë njohje të metodologjive të zbatimit të programeve të biologjisë;</li> <li>zotërojnë kërkesat e programeve për vlerësimin e arritjeve të nxënësve duke përdorur teknikat dhe instrumentet e diagnostikimit dhe të vlerësimit.</li> <li>përdorë programet e biologjisë, standardet e fushës së të nxënësve, standardet lëndore të biologjisë dhe udhëzuesit në planifikimet mësimore vjetore, ditore etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Programet lëndore të biologjisë për arsimin parauniversitar.</li> <li>Udhëzuesi lëndor i biologjisë së gjimnazit, IKT, 2009.</li> <li>Planifikim i mësimdhënies në lëndën e biologjisë, ISP, 2001.</li> <li>Kurrikula e arsimit nëntë vjeçar, Shkencat dhe Teknologjia, “Udhëzues për mësuesit”, IKS, 2006.</li> <li>Udhëzues për zhvillimin e Kurrikulës, IKS, 2006.</li> <li>Module për mësuesit e biologjisë, ISP, 2003.</li> <li>Kurrikula dhe shkolla, Biologji (Nr.5), ISP.</li> <li>Objektivat e arritjeve të kapitullit (linjës), QTKA, Nëntor 2007.</li> <li>Hartimi i objektivave të arritjes së nxënësve, IKT, 2008.</li> <li>Standardet e mësuesit të biologjisë, IKT, 2009.</li> <li>Udhëzuesi kurrikular i gjimnazit, IZHA, 2010. Etj.</li> </ul>

## Fusha : Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë të...	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> <li>zhvillojë mësimdhënie në përshtatje me synimet dhe objektivat e programeve të biologjisë;</li> <li>përdorë një sërë strategjish dhe metodash të përshtatshme, duke nxitur barazinë dhe gjithëpërfshirjen e nxënësve.</li> <li>vlerësojë burime të ndryshme të mësimdhënies dhe materialet kurrikulare që ndihmojnë në prezantimin në mënyrë sa më të qartë dhe të dobishëm të ideve dhe koncepteve biologjike;</li> <li>skicojë hartën e koncepteve të një blloku tematik;</li> <li>demonstrojë njohje të teknikave të formulimit të objektivave dhe të vlerësimit të tyre;</li> <li>grupojë objektivat e një blloku tematik sipas temave;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Metodika e mësimdhënies së biologjisë (K.Misja, A.Paparisto, A.Kacorri) 2005.</li> <li>Metoda të mësimdhënies. AEDP, 1999.</li> <li>Strategjitë e të mësuarit, ISP, 1995. <ul style="list-style-type: none"> <li>Mësimdhënia si marrje vendimesh.</li> <li>Vendime për planifikimin mësimor.</li> <li>Koha e caktuar për mësimdhënie.</li> <li>Si të bëjmë pyetjet?</li> <li>Vendime për diskutimet.</li> <li>Marrja e vendimeve për metodat e të pyeturit.</li> <li>Vendime për të nxitur të menduarit kritik.</li> <li>Drejtimi i klasës.</li> </ul> </li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• planifikojë një orë mësimore (teorike, punë laboratorit etj) me të gjitha hapat proceduralë të nevojshëm.</li> <li>• shpjegojë parimet e hartimit të një testi;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pedagogji e përgjithshme, G.Mialaret, ISP, 1995. <ul style="list-style-type: none"> <li>- Metodave analitiko-sintetike.</li> <li>- Metodave sintetike.</li> <li>- Metodave aktive. Bazat psikologjike të metodave aktive.</li> <li>- Metodave e orientuara drejt individualizimit të punës.</li> <li>- Avantazhet psikopedagogjike të punës së individualizuar.</li> <li>- Evolucionin e teknikës dhe edukimit.</li> <li>- Teknika audiovizive dhe proceset e reja psikike.</li> <li>- Informatika dhe edukimi.</li> </ul> </li> <li>• Të mësuarit me projekte, ISP, 2006.</li> <li>• Braktisja e fshehtë, S. Llambiri.</li> <li>• Kurrikula dhe shkolla, Biologji, Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, ISP.</li> <li>• Si të shkruajmë një ese, B.Musai.</li> <li>• Objektivat e arritjeve të kapitullit (linjës), QTKA, nëntor 2007.</li> <li>• Hartimi i objektivave të arritjes, IKT, 2008.</li> <li>• Kurrikula e arsimit nëntë vjeçar, Shkencat dhe Teknologjia, “Udhëzues për mësuesit”, IKS, 2006.</li> <li>• Udhëzuesi kurrikular i gjimnazit, IZHA, 2010.</li> <li>• Rregullore për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz, IZHA, 2010.</li> <li>• Si të hartojmë një test, Save the Children</li> <li>• Etj.</li> </ul>
---	---

## Fusha : Përmbajtja shkencore e lëndës

<b>Rezultati</b> <b>Mësuesi do të jetë i aftë të...</b>	<b>Literatura</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• zotërojnë konceptet e përbashkëta të shkencave natyrore dhe të zhvillojnë punë laboratorit e veprimtari praktike në përputhje me masat e sigurisë;</li> <li>• demonstrojnë konceptim të saktë dhe të plotë për natyrën e njohurive shkencore përmes zotërimit të elementeve të një kërkimi shkencor;</li> <li>• vlerësojnë zhvillimin historik të mendimit shkencor dhe aplikimin e shkencës në jetë;</li> <li>• shpjegojnë se si ndikon biologjia në jetën e përditshme të nxënësve dhe në vendimmarrjet personale dhe shoqërore të tyre;</li> <li>• analizojnë veçoritë e së gjallës në nivelin qelizor;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Tekste shkollore</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Biologji 6, 7, 8, 9 si dhe 10, 11, 12 (profili natyror, shoqëror).</li> </ul> </li> <li><b>Biologji 6</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Biosfera</li> <li>-Zinxhiri ushqimor</li> <li>-Jeta në mjedise ujore e tokësore</li> <li>-Edukim shëndetësor</li> </ul> </li> </ul>

- përshkruajë bazën materiale të trashëgimisë dhe të shpjegojë transmetimin e tipareve nga prindërit tek pasardhësit;
- përshkruajë klasifikimin e gjallesave sipas kriterëve shkencorë;
- analizojë veçoritë e së gjallës në nivelin organizmit;
- shpjegojë marrëdhëniet midis gjallesave dhe marrëdhëniet midis gjallesave dhe mjedisit;
- analizojë faktorët që ndikojnë në zhvillimin evolutiv të gjallesave.

### **Biologji 7**

- Organizimi i trupit të njeriut.
- Edukim shëndetësor

### **Biologji 8**

- Klasifikimi i gjallesave
- Historia e jetës në tokë

### **Biologji 9**

- Qeliza , mjedisi,
- Transporti i lëndës,
- Funksionet,
- Riprodhimi.

Teksti i nxënësit “biologji” 1, 2, 3, 4;

### **Biologji 1**

- Qeliza ,funksionet e organeleve qelizore
- Prodhimi i energjisë në prani dhe në mungesë të oksigjenit, (frymëkëmbimi dhe fermentimi)
- Mbretëritë e gjallesave,( studim i krahasuar)
- Bazat e ekologjisë

### **Biologji 2**

- Baza materiale e trashëgimisë (ADN e ARN) biosinteza e proteinave
- Mitoza ,mejoza, funksioni i riprodhimit tek bimët e kafshët
- Ligjet e trashëgimisë ,ushtrime

### **Biologji 3**

- Gjenetika e popullatave,ushtrime
- Lloji dhe mekanizmat riprodhuese
- ADN-rekombinante
- Bioteknologjia
- Organizimi hierarkik i trupit të njeriut (indet, organet, sistemet dhe aparatet, ndërtimi dhe funksionet e tyre.

### **Biologji 4**

- Gjenetika e njeriut
- Veprimtaria nervore
- Biosfera dhe mjedisi

- Biologji 10, 11 për gjimnazin.
- Fletore të punëve laboratorike.

- Botime me ushtrime dhe problema nga lënda e biologjisë.